



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.06/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, nga Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga E.A. nga Prishtina, Rr. “”, objekti ./.., ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Apelit, F.S., lidhur me ndërhyrjen në lëndën P.nr.1648/17, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1 dhe 5 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, me datë **04.07.2022**, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga E.A. nga Prishtina, ndaj gjyqtarës së Gjykatës së Apelit F.S., lidhur me pretendimin për ndërhyrje në lëndën P.nr.1648/17.

A r s y e t i m

Me datën 14.06.2022, pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka mbërritur ankesa e ankuesit E.A. nga Prishtina. Parashtruesi në ankesë pretendon për mos respektim të procedurës gjyqësore në çështjen penale P.nr.1648/17, në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa pretendon për ndërhyrje në të njëjtën çështje penale nga F.S.-gjyqtare e Gjykatës së Apelit.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të ankesës ka kërkuar nga gjyqtarja F.S., që të jap deklaratë lidhur me ankesën.

Gjyqtarja F.S., ka dhënë deklaratë me datën 17.06.2022, duke theksuar se: “ Nuk e kuptoj fare arsyen pse emri im është përmend në këtë shkresë derisa çështja është penale dhe nuk ka të bëjë me mua si Departament e as instancë apo shkallë ku punoj dhe gjykoj unë. Personin e lartcekur nuk e njoh fare dhe nuk e kuptoj arsyen pse jam përmend në këtë shkresë, të thënat aty janë tërësisht të paqëndrueshme dhe të pavërteta, prandaj duke mos e kuptuar tendencën (deklarimin e rrejshëm) të personit në fjalë nuk kam çka të shtoj tutje”.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës të gjyqtarës, konsideron se:

-Ankesa është e pabazuar

Kryetari i Gjykatës, e shqyrtoj ankesën e parashtruar, si dhe deklaratën e gjyqtares ndaj së cilës është ushtruar ankesë dhe vlerësoj se pretendimet ankimore sa i përket ndërhyrjes së gjyqtares F.S. në lëndën penale P.nr.1648/17, e cila lëndë është në shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme, për faktin se ankuesi nuk ka bashkëngjitur ndonjë provë me të cilën do të vërtetonte pretendimet e tij lidhur me ndërhyrjen eventuale të gjyqtares F.S., në çështjen penale P.nr.1648/17.

Kryetari i Gjykatës vlerëson, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me çështjen e parashtruesit të ankesës, meqenëse përveç deklarimeve të parashtruesit në ankesë nuk ka ndonjë provë tjetër konkrete me të cilën mund të vërtetohet se gjyqtarja ka ndërhyrë në çështjen P.nr.1648/17, e me ç ‘rast do të bënte shkelje të Kodit të Etikës.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

ADGJA.nr.06/2022, me datë 04.07.2022

**Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj**

Vendimi ti dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtares,
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,